



Në bazë të Programit për aktivitetet nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2023 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 08/23), dhe në lidhje me nenin 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e evenimenteve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal nr. 08-5380/1 të datës 22.05.2023, Qyteti i Shkupit shpall:

## **Thirrje publike**

### **për financim të projekteve nga fusha e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2023**

#### **1. Përshkrimi i thirrjes publike**

Me thirrjen publike do të financohen projekte nga fusha e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2023 për:

- Organizimin e trajnimeve
- Organizimin e evenimenteve
- Fushata promovuese

Për financimin e projekteve nga fusha e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, janë paraparë mjete në shumën e përgjithshme prej 2.000.000 denarë.

Përcaktimi i mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2023 (nën programi G1, zëri 464, nën zëri 464990) – të përcaktuara për financim të projekteve nga fusha e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, do të realizohet në bazë të Programit për aktivitetet nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2023 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 08/23).

## 2. E drejta për pjesëmarrje në thirrjen publike

Të drejtën për pjesëmarrje në thirrjen publike e kanë të gjithë personat juridik jo profitues, të regjistruar në Regjistrin qendrorë me seli në Shkup, në pajtim me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet dhe Ligjin për shoqëritë tregtare, të cilët e përmbushin kushtin dhe kriteret e përgjithshme nga kjo thirrje publike dhe të cilët kanë dorëzuar dokumentacionet e nevojshme.

**3. Kushti për pjesëmarrje** – Çdo aplikant mund të merr pjesë në thirrjen publike vetëm me një projekt.

## 4. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim në thirrjen publike:

- Gjendja aktuale rrjedhëse nga Regjistri Qendrorë ose Aktvendimi për regjistrim të shoqatës ose fondacionit;
- Deklarata e nënshkruar për obligimet e paguara ndaj Qytetit të Shkupit (tatimet, taksat komunale);
- Vërtetimi se nuk posedon ndalesën për pjesëmarrje në procedurat lidhur me thirrjen publike, ndarjen e kontratave për furnizime publike dhe kontratave për partneritet privat publik (Regjistri qendrorë);
- Propozim projekti i plotësuar në trajtë digjitale, me shkronja shtypi me alfabetin cirilik;
- Plani financiar i plotësuar në trajtë digjitale (fletë paraqitja për përkrahje financiare) me shkronja shtypi me alfabetin cirilik;
- Lista referuese ose dëshmi (kontratë e nënshkruar për së paku një projekt të realizuar në fushën për të cilën aplikohet).

Formularët Fletëparaqitja dhe Projekti për paraqitjen aplikuese në thirrjen publike, si dhe Rregullorja në të cilën janë të përcaktuara kriteret themelore për zgjedhje, parashtruesit mund ti marrin në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit - [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose në Sektorin për zhvillim ekonomik lokal në Qytetin e Shkupit.

## 5. Kriteret themelore për zgjedhjen e aplikuesve janë:

Kriteret	Pikat maksimale
<b>1. Struktura organizative dhe resurset</b>	<b>30</b>
1.1 Vallë aplikanti posedon strukturën e nevojshme organizative dhe resurset njerëzore për realizimin e projektit (të punësuar, vullnetarë aktiv, persona të angazhuar me honorarë, etj.)	10
1.2 Vallë aplikuesi disponon me logjistikën e nevojshme (hapësira të zyrave dhe pajisjet teknike për realizim të	10

manifestimit)	
1.3 Transparenca e aplikantit - online	10
<b>2. Financimi i projektit</b>	<b>30</b>
2.1 Plani financiarë i përpiluar në mënyrë të detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e evenimentit	10
2.2 Vallë aplikanti siguron përqindjen e pjesëmarrjes pronësore në realizimin e projektit	10
2.3 Vallë plani i propozuar financiar është real (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive dhe pozitave përkon me çmimet e tregut)	10
<b>3. Cilësia e projektit</b>	<b>40</b>
3.1 Në çmasë, qëllimi i përgjithshëm i projektit do të kontribuon për realizimin e prioriteteve të përcaktuara, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë përkatëse	10
3.2 Vallë janë ofruar zgjidhje cilësore dhe inovative në propozim projektin	10
3.3 Vallë është siguruar inkuadrimi i institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4 Vallë plani për realizimin e projektit është i qartë dhe i realizueshëm	10

\*Çdo fushë nga kriteret e veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pika ose me 10 pika, me kuptimin vijues: 1-jo, 5-pjesërisht dhe 10-po.

**Periudha e realizimit të projekteve** - më vonë deri më 1 dhjetor të vitit 2023.

## **6. Mënyra e realizimit të thirrjes publike**

Për përcaktimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përgjithshme nga pika 5 e thirrjes publike, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për realizimin e procedurës për financimin e projekteve nga fusha e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2023.

Për aplikimet që janë të kompletuara, të dorëzuara në kohë dhe të cilat i përmbushin kriteret nga pika 5, Komisioni dorëzon propozim deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit për ndarjen e mjeteve financiare për aplikantët.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, në propozim të Komisionit miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare.

Komisioni i njofton parashtruesit, fletë aplikimet e të cilëve janë refuzuar si të pa kompletuara, të dorëzuara me vonesë dhe të cilët nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara me pikën 5 të thirrjes.

## **7. Afati dhe mënyra e parashtrimit të fletë paraqitjeve**

Fletë paraqitja me dokumentacionin e tërësishëm, duhet të dorëzohet vetëm në trajtë të letrës deri te arkivi i Qytetit të Shkupit, në bul. “Ilinden” nr. 82 Shkup, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, **me shenjën** – “Thirrje publike për financimin e projekteve nga fusha e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2023.”.

Fletëparaqitjet dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shënim të subjektit i cili parashtron fletë paraqitjen, **në afatin prej 30 ditëve nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.**

**Vërejtje: Fletë paraqitja me dokumentacione të pa kompletuara ose fletë paraqitjet të cilat do të dorëzohen pas skadimit të afatit të paraparë, nuk do të shqyrtohen.**

**Shtojcat e dorëzuara nuk do të kthehen.**

Pjesëmarrësit në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet në afatin prej 15 ditëve nga dita e miratimit të Aktvendimit për ndarjen e mjeteve financiare.

Pyetjet për sqarime plotësuese mund të parashtrohen me shkrim ose përmes trajtës elektronike deri te Sektori për zhvillim ekonomik lokal në adresën: Daniela.Krsteska@skopje.gov.mk.

Kontakti: Sektori për zhvillim ekonomik lokal

Tel: (02) 3297-328